



**REPUBLIKA E KOSOVËS - ZYRA E PRESIDENTES**  
**REPUBLIC OF KOSOVO - OFFICE OF THE PRESIDENT**  
**REPUBLIKA KOSOVO - KANCELARIJA PREDSEDNICE**

**KËSHILLIT KONSULTATIV PËR KOMUNITETE**  
**CONSULTATIVE COUNCIL FOR COMMUNITIES**  
**KONSULTATIVNO VEĆE ZA ZAJEDNICE**



**Prishtinë, 2022**

## PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse e Kryesuesit të Këshillit.....	1
Fjala hyrëse e Sekretares së Këshillit .....	2
I. Përmbledhja ekzekutive .....	3
II. Themelimi i Këshillit Konsultativ për Komunitete.....	3
III. Udhëheqja, përbërja dhe struktura organizative e Këshillit Konsultativ për Komunitete.....	4
IV. Statusi dhe Mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete: .....	6
V. Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete .....	8
VI. Objektivat e Punës për vitin 2021 .....	9
VII. Aktivitetet e Këshillit për periudhën raportuese .....	9
VIII. Organizimi i takimeve me Organizatat Përfaqësuese të Komuniteteve.....	27
IX. Buxheti i Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe raporti financiar.....	28
X. Përfundime .....	29

## Fjala hyrëse e Kryesuesit të Këshillit

Nga themelimi i vitit 2008 Këshilli Konsultativ për Komunitete në Republikën e Kosovës, ka funksionuar në mënyrë të suksesshme. Kam kënaqësinë e veçantë të paraqes raportin vjetor të punës së Këshillit, i cili paraqet mekanizmin kryesor për konsultim, bashkërendim dhe shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore.

Raporti pasqyron veprimet dhe aktivitetet kryesore të zhvilluara nga Këshilli, në drejtim të përmbushjes së kompetencave dhe përgjegjësisve ligjore të Këshillit, si dhe objektivave të punës nga Plani Vjetor i Punës për vitin 2021.

Sikundër edhe viteve të mëparshme, edhe gjatë këtij viti, Këshilli Konsultativ për Komunitete me përkushtim të madh ishte i angazhuar në përmbushjen e funksioneve dhe mandatit kushtetues e ligjor të tij.

Këshilli ka qenë i fokusuar në organizimin dhe në artikulimin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre përmes takimeve me përfaqësuesit e institucioneve të shtetit, shqyrtimit dhe dhënies së rekomandimeve në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për komunitetet jo shumicë.

Përmbushja e objektivave të identifikuara është fryt i punës ekipore të anëtarëve të Këshillit dhe personelit të Sekretariatit, prandaj përfitoj nga rasti t'ju shpreh mirënjohjen gjithë anëtarëve të Këshillit dhe personelit të Sekretariatit për kontributin e dhënë dhe rezultatet e arritura në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve jo shumicë.

Veçmas, në emrin tim dhe të anëtarëve të Këshillit, falënderoj Presidenten e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani Sadriu dhe kabinetin e saj për inkurajimin, përkrahjen dhe mbështetjen e pa rezervë që na kanë ofruar në implementimin e mandatit të Këshillit, duke e shndërruar dhe mbajtur në këtë mënyrë Këshillin ndër mekanizmat institucionalë më të rëndësishëm në mbrojtjen dhe në promovimin e të drejtave të komuniteteve në Republikën e Kosovës.

**Agim Ferati**

## Fjala hyrëse e Sekretares së Këshillit

Të nderuar anëtarë të Këshillit,

Në zbatim të mandatit, përgjegjësive dhe detyrave ligjore, Këshilli ka miratuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2021, në të cilin janë përcaktuar objektivat e punës dhe aktivitetet për realizim.

Në zbatim të këtij plani dhe mandatit kushtetues dhe ligjor, Këshilli, grupet punuese dhe Sekretariati, kanë punuar me përkushtim të madh përkundër rrethanave dhe situatave sidomos gjatë ballafaqimit me pandeminë COVID 19.

Në kuadër të raportit të përgjithshëm të punës së Këshillit, raporti i punës së Sekretariatit pasqyron në mënyrë përmbledhëse aktivitetet kryesore të zhvilluara nga Sekretariati, në drejtim të përmbushjes së objektivave të punës nga Plani Vjetor i Punës për vitin 2021.

Edhe gjatë këtij viti, personeli i Sekretariatit ishte i përkushtuar në arritjen e objektivave të përcaktuara të punës për vitin 2021. Në mënyrë të veçantë, Sekretariati ishte i fokusuar në sigurimin me kohë të shërbimeve profesionale dhe administrative për Këshillin dhe grupet punuese të tij. Duke zhvilluar në afate kohore aktivitetet e planifikuara dhe duke realizuar synimet e parapara, Sekretariati ka arritur plotësisht objektivat e punës të përcaktuara me Planin Vjetor të Punës për vitin 2021.

Zhvillimi i aktiviteteve në realizimin dhe arritjen e objektivave specifike të punës është rezultat i punës ekipore të personelit të Sekretariatit, prandaj dëshiroj t'i shpreh mirënjohje gjithë personelit të Sekretariatit për angazhimet e tyre dhe sukseset e arritura në zbatimin e planeve të punës, si dhe në sigurimin e funksionimit me efektivitet të Këshillit.

Veçmas, në emrin tim dhe të personelit të Sekretariatit, falënderoj Presidenten e Republikës së Kosovës, Dr. Vjosa Sadriu Osmani dhe kabinetin e saj, për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me ne.

Sekretariati, po ashtu, edhe në vitin 2022, mbetet i përkushtuar në zbatimin e përgjegjësive të caktuara ligjore dhe Planit Vjetor të Punës, për të siguruar funksionim efikas dhe administrimin e mirëfilltë të Këshillit.

**Nafiye Gaş**

## I. Përmbledhja ekzekutive

Për realizimin dhe përmbushjen e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës, është i një rëndësie të veçantë ekzistimi i institucioneve dhe mekanizmave të veçantë. Në këtë kuadër, në nenin 60 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është parashikuar formimi i Këshillit Konsultativ për Komunitete, në të cilin përfaqësohen nëntë (9) komunitete, me qëllim të realizimit të lirive dhe të të drejtave të pjesëtarëve të tyre. Këshilli vepron nën autoritetin e Presidentit të Republikës së Kosovës, ndërsa në përputhje me mandatin kushtetues dhe funksionet e përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, Këshilli përfshin ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës, si dhe mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse.

Në zbatim të mandatit, përgjegjësive dhe detyrave ligjore, Këshilli ka miratuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2021, në të cilin janë përcaktuar objektivat e punës dhe aktivitetet për realizim.

Në zbatim të këtij plani dhe mandatit kushtetues dhe ligjor, Këshilli, grupet punuese dhe Sekretariati, kanë punuar me përkushtim.

Sekretariati i Këshillit ka punuar me përkushtim në sigurimin e mbështetjes profesionale dhe administrative të Këshillit, në sferën e dhënies së këshillave ligjore, përpilimin e rekomandimeve, organizimin e takimeve dhe në menaxhimin e buxhetit të KKK-së.

Në vitin raportues është siguruar pjesëmarrja e përfaqësuesve të organeve dhe institucioneve të tjera në punën dhe aktivitetet e Këshillit, si dhe është thelluar më tej bashkëpunimi me institucionet shtetërore, organizatat ndërkombëtare, OJQ-të dhe mediat.

Këshilli ka kodin e vet buxhetor. Për vitin fiskal 2021, në kategorinë paga dhe mëditje, janë ndarë 36,781.24 euro, ndërsa në kategorinë mallra dhe shërbime janë ndarë 82,390.00 euro. Kërkesat për ekzekutimin e pagave, mëditjeve dhe sigurimin e shërbimeve parashtrihen nga ana e Sekretarit të Këshillit, ndërsa ekzekutimi i kërkesave bëhet nga ana e zyrtarëve përkatës të Zyrës së Presidentit.

## II. Themelimi i Këshillit Konsultativ për Komunitete

Këshilli është themeluar nën ombrellën e Presidentit të Republikës së Kosovës, në përputhje me nenin 60 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 12 të Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës dhe në bazë të Statutit për themelimin e Këshillit të miratuar me anë të Dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. KKK-01-2008, i shfuqizuar me Dekretin Nr. KKK-001-2012, me qëllim avancimi të qasjes dhe pjesëmarrjes së komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në jetën publike, ekonomike dhe sociale në Kosovë.

### Vizioni

Një mekanizëm funksional, efektiv dhe i qëndrueshëm në gjendje për të përfaqësuar dhe për të adresuar nevojat, pikëpamjet dhe interesat e të gjitha komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.

### Misioni

Misioni i Këshillit është që, si një mekanizëm për konsultim, bashkërendim dhe shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore, t'ju ndihmojë komuniteteve jo shumicë dhe pjesëtarëve të tyre në realizimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore, si dhe sigurimin e qasjes dhe pjesëmarrjen në jetën politike, ekonomike, sociale dhe kulturore në Kosovë.

## III. Udhëheqja, përbërja dhe struktura organizative e Këshillit Konsultativ për Komunitete


### 1. Udhëheqja e Këshillit Konsultativ për Komunitete


Këshilli udhëhiqet nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhe Kryesia e tij në përputhje me nenin 12, pika 4 dhe pika 5 të Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, si dhe nenit 12, 13 dhe 14 të Statutit të Këshillit. Kryesia e Këshillit përbëhet nga kryesuesi dhe dy (2) zëvendësit e kryesuesit, të cilët zgjidhen me anë të shumicës së thjeshtë nga radhët e anëtarëve të emëruar nga Presidenti i Republikës së Kosovës. Asnjëri nga mbajtësit e këtyre posteve nuk përfaqëson të njëjtin komunitet. Kryesuesi dhe zëvendësit e kryesuesit kanë mandat prej një (1) viti, me mundësi të vazhdimit edhe për një (1) vit tjetër.

## 2. Përbërja e Këshillit Konsultativ për Komunitete

Këshilli Konsultativ për Komunitete përbëhet nga përfaqësues të të gjitha komuniteteve të Kosovës dhe përfaqësues të Qeverisë, Zyrës së Presidentes dhe agjencive të tjera relevante, siç është përcaktuar me nenin 12 (6) të Ligjit Nr. 04/L-020 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-047 Për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre në Republikën e Kosovës, që përfshin:

- nga dy (2) përfaqësues të komunitetit rom, egjiptian, goran, ashkali, malazez dhe kroat, prej të cilëve nga një (1) mund të jetë deputet i Kuvendit;
- nga tre (3) përfaqësues të komunitetit boshnjak dhe turk, prej të cilëve nga një (1) mund të jetë deputet i Kuvendit;
- pesë (5) përfaqësues të komunitetit serb, prej të cilëve dy (2) mund të jenë deputetë të Kuvendit;
- një (1) përfaqësues i lartë i Zyrës së Presidentit;
- tre (3) përfaqësues të lartë të Qeverisë, që caktohen nga ministria apo agjencia, fushëveprimi i të cilave është me rëndësi të veçantë për komunitet.






### 3. Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete

Këshilli Konsultativ për Komunitete mbështetet nga Sekretariati, i vendosur në Zyrën e Presidentes së Republikës së Kosovës.

Sekretariati udhëhiqet nga Sekretari i Këshillit, i cili i përgjigjet dhe raporton i drejtpërdrejt Presidentes për fushën që mbulon ky Sekretariat, ndërsa për çështje administrative i përgjigjet sekretarit të Zyrës së Presidentes.

Në kuadër të Sekretariatit janë të angazhuar dy (2) zyrtar të lart ligjor për komunitete dhe një (1) zyrtar i lart për komunikim.





*Struktura organizative e Këshillit Konsultativ për Komunitete*

#### **IV. Statusi dhe Mandati i Këshillit Konsultativ për Komunitete:**

##### **Statusi i Këshillit**

Këshilli vepron nën autoritetin e Presidentit, në të cilin përfaqësohen të gjitha komunitetet.

##### **Pavarësia e Këshillit**

Këshilli, në pajtim me mandatin e tij, është i pavarur dhe vepron në emër të vet gjatë miratimit të vendimeve, rekomandimeve apo kur ndërmerret ndonjë veprim.

Vendimet, rekomandimet dhe veprimet e Këshillit nuk do t'i atribuohen Presidentit.

Kryesuesi, zëvendës kryesuesit dhe anëtarët e Këshillit mbajnë bashkëpërgjegjësinë për vendimet, rekomandimet dhe veprimet që ndërmerret Këshilli, si dhe përgjegjësinë individuale për veprimet e tyre.

## Mandati i Këshillit

1. Mandati i Këshillit, siç është përcaktuar me nenin 60 (3) të Kushtetutës, përfshin:
  - 1.1. Ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë;
  - 1.2. Mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse;
  - 1.3. Çdo përgjegjësi a funksion tjetër, në pajtim me Ligjin.
2. Këshilli gjithashtu ka mandat të përcaktuar me nenin 12 (1) të Ligjit, që përfshin:
  - 2.1. të ndihmojë në organizimin dhe në artikulumin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për to;
  - 2.2. Të ofrojë një forum për konsultim dhe bashkërendim ndërmjet komuniteteve dhe të sigurojë funksionimin efikas të organizatave përfaqësuese të komuniteteve, në përputhje me Kodin e Mirësjelljes, që do të miratohet nga Këshilli;
  - 2.3. Të ofrojë një mekanizëm për shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve shtetërore;
  - 2.4. T'ua ofrojë mundësinë komuniteteve që, në faza të hershme, të marrin pjesë në nismat ligjore apo të politikave, të cilat përgatiten nga Qeveria dhe Kuvendi, të sugjerojë nisma të tilla dhe që mendimi i tyre të inkorporohet në projekte dhe në programe përkatëse, përfshirë Strategjinë gjithëpërfshirëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe raportin vjetor gjithëpërfshirës që Qeveria ia paraqet Kuvendit për zbatimin e strategjisë së saj, në pajtim me Ligjin;
  - 2.5. Të plotësojë kërkesën për konsultime të tjera të detyrueshme në relacion me akte të caktuara ligjore, që janë paraparë në Kushtetutë dhe ligj;
  - 2.6. T'ua mundësojë komuniteteve të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve që u kushtohen pjesëtarëve të tyre apo që kanë rëndësi të posaçme për ta;
  - 2.7. Të japë rekomandime gjatë procesit të vendimmarrjes në lidhje me caktimin e fondeve, qofshin ato ndërkombëtare apo të ndara nga buxheti i Republikës së Kosovës, për projekte që u dedikohen komuniteteve apo interesave të tyre të veçanta;
  - 2.8. Të kontribuojë në raportimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës para mekanizmave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe

2.9. Të rrisë vetëdijen për brengat e komuniteteve brenda Republikës së Kosovës dhe të kontribuojë në marrëdhëniet e harmonishme ndërmjet të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës.

### **Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Këshillit**

1. Këshilli shkëmben informacione me organet përkatëse të Qeverisë dhe institucionet e tjera dhe jep rekomandime lidhur me komunitetet në Kosovë me qëllim që të nxisë, të mbështesë dhe të promovojë barazi të plotë dhe efektive të pjesëtarëve të komuniteteve në të gjitha fushat e jetës ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore dhe pjesëmarrjen efektive të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në jetën publike dhe në vendimmarrje, duke ndërmarrë, por duke mos u kufizuar në masat, si në vijim:
  - 1.1. ndihmon në organizimin dhe në artikulumin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikën dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për to;
  - 1.2. u mundëson komuniteteve që të marrin pjesë në vlerësimin e nevojave, hartimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve dhe strategjive që u kushtohen pjesëtarëve të tyre, apo që kanë rëndësi të posaçme për to;
  - 1.3. rekomandon gjatë procesit të vendimmarrjes në lidhje me caktimin e fondeve, qofshin ato ndërkombëtare, apo të ndara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për projekte që u dedikohen komuniteteve, apo interesave të tyre të veçanta;
  - 1.4. kontribuon në raportimin e Qeverisë që u drejtohet mekanizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, ngre vetëdijen për brengat e komuniteteve brenda Republikës së Kosovës dhe kontribuon në marrëdhëniet harmonike ndërmjet të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës, si dhe
  - 1.5. bashkëpunon me Qeverinë në organizimin e ditëve memoriale të komuniteteve.

### **V. Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete**

1. Këshilli Konsultativ për Komunitete mbështetet nga Sekretariati, i vendosur në Zyrën e Presidentit të Republikës së Kosovës.
2. Sekretariati udhëhiqet nga Sekretari i Këshillit, i cili i përgjigjet dhe raporton drejtpërdrejt Presidentit për fushën që mbulon ky Sekretariat, ndërsa për çështje administrative i përgjigjet sekretarit të Zyrës së Presidentit.
3. Sekretari i Këshillit dhe të punësuarit e tjerë të Sekretariatit përzgjidhen, emërohen dhe shkarkohen në pajtim me dispozitat ligjore për nëpunësit civilë.
4. Detyrat dhe përgjegjësitë e Sekretariatit janë, si në vijim:

- 4.1. mbështet dhe promovon aktivitetet e Këshillit;
- 4.2. mbështet Këshillin dhe grupet e tij punuese duke përfshirë organizimin e takimeve, përgatitjen e rendit të ditës dhe mbajtjen e procesverbaleve nga takimet e tyre;
- 4.3. ndihmon që Këshilli t'i përmbushë detyrimet e tij sipas Ligjit, sipas këtij statuti dhe sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
- 4.4. është përgjegjës për të planifikuar dhe për të menaxhuar me buxhetin e Këshillit;
- 4.5. ndihmon Këshillin në dhënien e mendimeve në projekt legjislacionin dhe projekt dokumentet e politikave të përgatitura nga Qeveria dhe Kuvendi. Për realizimin e kësaj pike, Sekretariati bashkëpunon edhe me Departamentin për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Presidentit;
- 4.6. pranon dhe dërgon të gjitha shkresat dhe komunikimet e tjera zyrtare për të gjithë anëtarët e Këshillit;
- 4.7. bën publikime për aktivitetet e Këshillit, kryen punët e informimit publik, si dhe përgjigjet në kërkesa për informata lidhur me punën e Këshillit;
- 4.8. përfaqëson Presidencën në zbatimin e procedurave të nominimit, të përfshira në Ligj dhe në Statut.
- 4.9. angazhohet në zhvillimin e studimeve dhe hulumtimeve për çështjen e komuniteteve dhe, sipas nevojës, kërkon këshilla nga ekspertë të jashtëm;
- 4.10. mbështet kryerjen e çfarëdo funksioni tjetër të Këshillit në pajtim me Ligjin, me Statutin dhe legjislacionin në fuqi.

## VI. Objektivat e punës për vitin 2021

Në zbatim të funksioneve dhe përgjegjësi të tij, Këshilli ka miratuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2021, në të cilin janë përcaktuar objektivat e punës, masat, aktivitetet, afatet për përmbushjen e tyre, institucionet dhe zyrtarët përgjegjës për zbatim.

### Objektivat për vitin 2021

1. Bashkëpunimi dhe koordinimi me institucionet e shtetit në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike që kanë rëndësi të veçantë për komunitetet.
2. Thellimi i bashkëpunimit me institucionet në nivelin qendror dhe lokal dhe sektorit joqeveritar me rëndësi për komunitetet.
3. Informimi i përhershëm dhe me kohë i publikut me punën dhe aktivitetet e Këshillit.

## VII. Aktivitetet e Këshillit për periudhën raportuese

Nisur nga mandati, kompetencat dhe përgjegjësit kushtetuese dhe ligjore të përcaktuara, si dhe në zbatim të Planit të Punës, siç u përshkruan në pikën IV, V dhe VI të këtij raporti, Këshilli gjatë vitit 2021, në mënyrë të organizuar dhe sipas dinamikës së paraparë, ka ndihmuar në organizimin dhe në artikullimin e pikëpamjeve të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre lidhur me legjislacionin, politikat dhe programet publike, që kanë rëndësi të veçantë për ta, duke ua ofruar mundësinë komuniteteve që, në faza të hershme, të marrin pjesë në nismat ligjore apo politikave të cilat përgatiten nga institucionet e shtetit të Kosovës.

Në mënyrë të posaçme, Këshilli ka ngritur, ka trajtuar dhe ka analizuar çështje me interes për pjesëtarët e komuniteteve, siç është fusha e arsimit, punësimit, përdorimit të gjuhëve dhe kulturës.

Bazuar në analizën e kryer të trajtimit dhe shqyrtimit të spektrit të gjerë të të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, Këshilli ka ngritur dhe ka kërkuar nga institucionet shtetërore të zbatojnë ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës dhe praktikat më të mira të njohjes dhe respektimit të të drejtave të komuniteteve në Republikën e Kosovës.

### Takimet e Këshillit që kryesohen nga Presidentja

Këshilli takohet dy (2) herë në vit, nën kryesimin e Presidentes, për ta bërë një shqyrtim të përgjithshëm të politikave dhe shqetësimeve të komuniteteve në Republikën e Kosovës.

Sekretariati, në bashkëpunim me Kabinetin e Presidentes dhe me Këshillin, bën organizimin e takimeve që kryesohen nga Presidentja.

Takimi i Presidentes me Këshillin është mbajtur më 14 dhjetor 2021.

Fjalimi hyrës i **Presidentes znj. Vjosa Osmani Sadriu**, në takimin me anëtarët e Këshillit.

Këshilli Konsultativ për Komunitete është njëri nga zërat më të rëndësishëm të komuniteteve në Kosovë.

Komunitete të caktuara përballen me probleme të natyrave specifike dhe jo gjithnjë sfidat janë të njëjlojta. Për këtë arsye institucionet synojnë përveç garantimit të të drejtave dhe lirive të tyre, të ndërtojnë edhe politika shtetërore përmes të cilave rregullohen problemet specifike me të cilat përballen komunitetet.

Punësimi, edukimi dhe zhvillimi socio-ekonomik janë disa nga sfidat e përditshme të gjithë qytetarëve pa dallim etnie. Si presidente e vendit së bashku me institucionet e tjera do të punojmë që këto probleme të eliminohen në veçanti për grupet që ndihen më të marginalizuara dhe që ballafaqohen me këto probleme në masë shumë më të

madhe, e siç e dimë, pandemia i ka vënë në pah shumë më shumë këto se në vitet paraprake.

Përpjekjet tona do të jenë të përbashkëta në këtë drejtim dhe gjithmonë do të më keni aleate.

Ndër prioritet kryesore të agjendës sime është edhe fuqizimi i gruas. Duke filluar nga fuqizimi i saj ekonomik e deri te ballafaqimi me problemet e përditshme, siç janë dhuna në familje, problemet e mungesës së punësimit dhe problemet e tjera. Prandaj, do të përkushtohemi fuqishëm që gratë jo vetëm të ndihen të barabarta për edhe të fitojnë e gëzojnë vendin e tyre meritore në shoqëri përfshirë gratë që i takojnë komuniteteve jo shumicë.

Diversiteti është një ndër vlerat kryesore të Kosovës dhe si e tillë kjo vlerë do të kultivohet edhe më tej me përkrahje institucionale.

Republika jonë edhe këtë vit ka parë raste të diskriminimit ndaj komuniteteve të caktuara, në veçanti ndaj komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Kjo jo vetëm që është e papranueshme por tregon se ne do të ecim përpara si shoqëri vetëm kur të gjithë bashkërisht, pavarësisht a jemi në institucione publike apo thjeshtë anëtar të kësaj shoqërie, luftojmë diskriminimin duke e ditur se ai ndalë ecjen përpara të shoqërisë tonë.

Ju ftoj që të jeni sa më aktiv në punën tuaj dhe të takoheni sa më shumë me qytetarë për artikulumin e kërkesave të tyre, ndërsa rekomandimet e Këshillit do të përkrahen nga Zyra e Presidentes.

Në takim z. Agim Ferati, Kryesues i Këshillit, prezantoi para Presidentes, punën e bërë të Këshillit gjatë vitit 2021. Më pas përfaqësuesit e komuniteteve në Këshill, z. Petar Đorđević, nga komuniteti serb, z. Almedin Fejza, nga komuniteti boshnjak, znj. Gúlten Nobirda, nga komuniteti turk, znj. Adelina Qorraj Emini nga komuniteti egjiptian, z. Ridvan Gashi nga komuniteti rom, z. Denis Ivić nga komuniteti malazez dhe z. Josip Cirimotić, nga komuniteti kroat prezantuan para Presidentes, sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohen komunitetet e tyre në fushën e arsimit, punësimit përdorimit të gjuhëve, të drejtat pronësore si dhe kërkuar mbështetjen e Presidentes në adresimin e tyre te institucionet përkatëse.

## **Takimet e rregullta të Këshillit**

Këshilli takohet një (1) herë në muaj.

Takimet e Këshillit i thërret dhe i udhëheq kryesuesi i Këshillit, në mungesë të tij, njëri nga zëvendës kryesuesit e tij.

Këshilli gjatë vitit 2021 ka mbajtur takimet e rregullta mujore, gjithsej dymbëdhjetë (12) takime.

Takimet e Këshillit, të grupeve punuese si dhe aktivitetet e tjera të realizuar për gjatë viti 2021 do të paraqiten në mënyrë kronologjike në vijim:

## Janar

Më 28 janar 2021, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.

Gjatë këtij muaji janë takuar pesë (5) grupet punuese të Këshillit:

- Grupi Punues për Çështje të Arsimit;
- Grupi Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale;
- Grupi Punues për Çështje të Kulturës;
- Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve;
- Grupi Punues për Legjislacion.

Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

## Shkurt

Më 25 shkurt 2021, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.

Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit,

Gjatë këtij muaji janë takuar katër (4) grupet punuese të Këshillit:

- Grupi Punues për Çështje të Arsimit;
- Grupi Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale;
- Grupi Punues për Çështje të Kulturës;
- Grupi Punues Çështje të Gjuhëve.

Këshilli në takim ka shqyrtuar dhe miratuar propozim rekomandimin e Grupit Punues për Çështje të Gjuhëve, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

### **Rekomandimi i Këshillit për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës**

Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës t'i ndërmarrin masat e nevojshme në mënyrë që të gjithë tekstet dhe njoftimet në ueb faqe dhe kanalet të tjera të komunikimit të përkthehen edhe të publikohen njëkohësisht në të gjitha gjuhët zyrtare, siç parashikohet me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

Që materialet për luftimin kundër pandemisë së virusit COVID-19 të jenë në dispozicion në të gjitha gjuhët në mënyrë që të gjithë t'i marrin njoftimet në gjuhën e tyre, sepse pandemia i sulmon të gjithë në të njëjtën mënyrë.

## **Këshilli nuk ka pranuar përgjigje as nga Ministria e Shëndetësisë as nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës**

Anëtarët, Ridvan Gashi dhe Atakan Koro më 05 shkurt 2021, ka marrë pjesë në konferencën me temën "Sfidat dhe arritjet në sistemin e arsimit të komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian.

Grupi Punues ka shënuar 21 Shkurtin Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare.

### **Mars**

Më 29 mars 2021, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.

Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Këshilli në takim ka shqyrtuar dhe miratuar raportin vjetor të punës për vitin 2020.

Gjatë këtij muaji janë takuar katër (4) grupet punuese të Këshillit:

- Grupi Punues për Çështje të Arsimit;
- Grupi Punues për Çështje të Kulturës;
- Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve;
- Grupi Punues për Legjislacion.

Kryesia e Këshillit, z. Aleksandar Rapajic, z. Almedin Fejza, dhe kryesuesit e grupeve punuese për legjislacion dhe çështje të gjuhëve, z. Agim Ferati dhe z. Ridvan Gashi, kanë pritur në takim z. Ognjen Gogic, përfaqësues nga OJQ AKTIV, i cili ka prezantuar iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

Në takimin e Grupit Punues për Çështje të Kulturës të mbajtur më 25 mars 2021, kanë marrë pjesë: znj. Esin Shisko dhe z. Iber Alaj, përfaqësues nga Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

### **Prill**

Më 29 prill 2021, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.

Gjatë këtij muaji janë takuar dy (2) grup punues të Këshillit.

- Grupi Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale;
- Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve

Në takim Këshilli ka miratuar propozim rekomandimin e Grupit Punues për Çështje të Gjuhëve.



## **Rekomandimi i Këshillit për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit.**

- Ministria e Punëve të Brendshme të funksionojë platformën "e-kosova" në gjuhën serbe, përkthimin dhe tekste në ueb faqe t'i harmonizojë me rregullat standarde dhe shprehjet në gjuhën serbe.
- Ministria e Punëve të Brendshme të ofrojë të njëjtën platformë në gjuhë të tjera të komuniteteve jo shumicë që janë në përdorim zyrtar në nivelin lokal (boshnjake, dhe rome) për shkak të numrit të madh të shërbimeve të ofruara nga kjo platformë dhe nën kompetencat e qeverive lokale.
- Ministria e Punëve të Brendshme të ndërmarrë të gjitha masat dhe hapat e nevojshme teknike dhe shtesë për ta respektuar plotësisht nenin 10, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit nr. 05 / L -015 për Letërnjoftim dhe për t'ua mundësuar pjesëtarëve të komunitetit boshnjak, turk dhe rom të marrin letërnjoftime në gjuhën boshnjake, dhe rome si gjuhë që janë në përdorim zyrtar në një numër të madh të komunave në nivelin lokal.

## **Këshilli nuk ka pranuar përgjigje as nga Ministria e Punëve të Brendshme as nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI).**

Kryesuesi i Këshillit, z. Aleksandar Rapajić, më 01 prill 2021, ka marrë pjesë në takimin e Komisionit për fillimin e procedurës për zgjedhjen e një (1) gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Grupi Punues për Çështje të Arsimit, më 16 prill 2021 ka realizuar takim me z. Dukagjin Pupovci, zëvendës ministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Në takim, anëtarët kanë prezantuar para z. Pupovci, sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve në fushën e arsimit. Z. Pupovci, në takim premtoi adresimin e tyre gjatë mandatit qeverisës.

Sekretariati i Këshillit në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike më 22-23 prill 2021, në Prizren, ka organizuar trajnimin për anëtarët e Këshillit dhe zyrtarët e Sekretariatit.

Temat e trajnimit:

- Roli detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Konsultativ për Komunitete.
- Këshilli Konsultativ për Komunitete dhe korniza ligjore dhe institucionale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve në Republikën e Kosovës.
- Procesi i hartimit të politikave dhe legjislacionit dhe mundësia e Këshillit Konsultativ për Komunitete për të komentuar në një fazë të hershme nismat legjislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria.
- Procesi i hartimit të rekomandimeve nga Këshilli Konsultativ për Komunitete.

## Maj

Më 27 maj 2021, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.

Gjatë këtij muaji janë takuar tre (3) grupet punuese të Këshillit:

- Grupi Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale;
- Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve;
- Grupi Punues për Legjislacion

Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Kryesuesi i Këshillit, z. Aleksandar Rapajić, më 06 maj 2021, ka marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit për shqyrtimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese.

Kryesuesi i Këshillit, z. Aleksandar Rapajić, më 17 maj 2021, ka marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit për testin me shkrim të kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese.

Anëtari i Këshillit, z. Ridvan Gashi, më 18 maj 2021, ka marrë pjesë në mbledhjen e Grupit punues teknik për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të organizuar nga Zyra e Kryeministrit.

Kryesuesi i Këshillit, z. Aleksandar Rapajić, më 24 maj 2021, ka marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit për intervistimin e kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese.

## Qershor

Më 30 qershor 2021, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.

Gjatë këtij muaji janë takuar pesë (4) grupet punuese të Këshillit:

- Grupi Punues për Çështje të Arsimit;
- Grupi Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale;
- Grupi Punues për Çështje të Kulturës;
- Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve;
- Grupi Punues për Legjislacion.

Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Kryesia e Këshillit, në përbërje z. Aleksandar Rapajić, z. Almedin Fejza, si dhe Sekretarja e Këshillit, znj Nafiye Gaş, më 03 qershor 2021 kanë realizuar takim me z. Artan Murati, zëvendës shef i kabinetit të Presidentes.

Në takimin e pestë online të nën-komitetit për drejtësi, liri dhe siguri në kuadër të procesit të stabilizim asociimit të organizuar nga BE-ja, të mbajtur më datë 9 dhe 10 qershor 2021, në temën “Koordinimi për të drejtat e përgjithshme të minoriteteve” në kuadër të Drejtave themelore dhe të drejtave të minoriteteve, ka prezantuar Sekretarja e Këshillit, znj. Nafiye Gaş.

Kryesuesi i Këshillit, z. Aleksandar Rapajić, më 10 qershor 2021, ka marrë pjesë në takimin e Komisionit për fillimin e Procedurës për zgjedhjen e dy (2) gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Kryesia e Këshillit, z. Aleksandar Rapajić, dhe z. Almedin Fejza, më 15 qershor 2021, kanë pritur në takim z. Gazmen Salijević, zëvendës ministër në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Në takim u diskutua lidhur me bashkëpunimin e Këshillit me Ministrinë në të ardhmen për çështjet me interes për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, me theks të veçantë për regjistrimin e popullsisë.

Kryesia e Këshillit, z. Aleksandar Rapajić, dhe z. Almedin Fejza, më 17 qershor 2021, kanë realizuar takim me znj. Emilija Redžepi, Zëvendëskryeministre për Çështje të Pakicave dhe të Drejtave të Njeriut në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Në takim u diskutua lidhur me bashkëpunimin e këtyre dy institucioneve në të ardhmen për çështjet me interes për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë.

Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve, në takimin e mbajtur më 23 qershor 2021, ka qenë i ftuar dhe ka marrë pjesë z. Elbert Krasniqi, ministri në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal. Në takim është diskutuar për bashkëpunimin e grupit punues dhe të Këshillit me ministrinë në të ardhmen lidhur me zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve nëpër komuna si dhe për iniciativat me interes të përbashkët për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës.

## Korrik

Më 29 korrik 2021, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.

Gjatë këtij muaji janë takuar katër (4) grupet punuese të Këshillit:

- Grupi Punues për Çështje të Arsimit;
- Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve;
- Grupi Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale
- Grupi Punues për Legjislacion.

Në takim Këshilli, ka miratuar propozim rekomandimin dhe komentet në Projektligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, si dhe propozim rekomandimin për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

### **Rekomandimi dhe komentet e Këshillit për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve**

#### **Rekomandimi i Këshillit Konsultativ për Komunitete në Projektligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave**

Në përputhje me mandatin e tij Këshilli Konsultativ për Komunitete propozon këtë plotësim-ndryshim të projektligjit:

### **Neni 9**

#### **Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti i tyre**

Pas paragrafit 3 të këtij neni, të shtohet edhe një paragraf si në vijim :

Paragrafi 4

#### **4. Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë mund të lëshohen me kërkesë individuale të qytetarit të Kosovës, e në përputhje me legjislacionin e vlefshëm për mbrojtjen e të dhënave personale.**

### **ARSYETIMI**

Këshilli Konsultativ për Komunitete aktualisht po merret me problemin e keqpërdorimit të disa të drejtave që sipas legjislacionit ne fuqi janë të rezervuara për anëtarët e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë. Këto të drejta shpesh keqpërdoren në mënyrën që njerëzit paraqiten në mënyrë të rremë si pjesëtarë të një komuniteti të caktuar për të fituar një dobi të caktuar, që drejtpërdrejt e bën të pakuptimtë qëllimin e diskriminimit pozitiv të parashikuar për komunitetet e caktuara në Kosovë.

Për atë qëllim, ideja e Këshillit është që sa më shpejtë ta miratojë propozimin e një dokumenti i cili do të konfirmonte se një person i përket një komuniteti të caktuar, ka disa shembuj të tillë në legjislacionin evropian. Ky dokument do të lëshohej vetëm me kërkesë personale të personit, nëse ai dëshiron, dhe vetëm për qëllimin e cekur saktësisht, dhe do t'u dorëzohej institucioneve që tashmë kanë detyrim për t'i mbrojtur të dhënat personale, ne konsiderojmë që kështu mbahet anonimiteti i të dhënave i parashikuar me nenin 9, pikën 2.

Një plotësim i tillë i ligjit është i domosdoshëm për të ardhur deri te ky dokument, sepse është një parakusht për aktivitetet e mëtejshme të Këshillit lidhur me këtë çështje.

Ne gjithashtu besojmë se mundësia që një qytetar t'i kontrollojë të dhënat e shënuara në regjistrim paraqet edhe një mënyrë tjetër shtesë për të kontrolluar procesin e regjistrimit dhe saktësinë e tij, e cila do ta përmirësojë të gjithë procesin.

## **Komentet e Këshillit Konsultativ për Komunitete në Projektligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave**

Këshilli Konsultativ për Komunitete ka shqyrtua Projektligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave, dhe ka miratuar komentet si në vijim:

### **Neni 4**

#### **Obligimi qytetar**

**Paragrafi 2 i nenit 4 të Projektligjit** të ndryshohet dhe të plotësohet, të jetë si në vijim:

**Neni 4 paragrafi 2** Çdo person është i lirë të tregojë një përkatësi etnike.

**Neni 8 i Projektligjit** të ndryshohet dhe të plotësohet, të jetë si në vijim:

### **Neni 8**

#### **Të dhënat e grumbulluara nga Regjistrimi**

1. Të dhënat e grumbulluara nga regjistrimi kategorizohen në:

1.1. të dhënat për identitetin e individit: emri, mbiemri, gjinia, data e lindjes, vendi i lindjes së personit (vendi, komuna), përkatësia etnike, fetare, shtetësia, niveli i shkollimit, adresa vendbanimi i përhershëm, statusi martesor, numri i fëmijëve të lindur gjallë, gjuha amtare, gjuhët e tjera që i flisni, arsyeja e mungesës nga vendbanimi i zakonshëm, vendbanimi i mëhershëm, ardhja në vendbanimin e zakonshëm, arsyeja e shpërnguljes, niveli i shkollimit në vijim, profili i shkollimit në vijim dhe atij të kryer, aftësia për shkrim lexim, punësimi, emërtimi i organizatës ku punon, profesioni, aftësitë e kufizuara, dhe çështje të tjera sociale dhe ekonomike;

1.2. të dhënat për ekonomitë familjare: emri dhe mbiemri i kryefamiljarit, raporti i anëtarëve me kryefamiljarin, statusi i banimit, banuesit e ekonomive familjare kolektive apo ( shtëpia e pleqve, bujtinat e punëtorëve, institucionet edukativo arsimore, burgjet, objektet fetare etj.), të dhënat për bujqësinë, duke përfshirë sipërfaqen e tokës së punueshme për të lashtat, për blegtorinë, fondin e makinerisë bujqësore, si dhe modalitete të tjera sipas udhëzimeve të tjera metodologjike;

1.3. të dhënat për banesë dhe ndërtesa: lloji i banesës, sipërfaqja e banesës, statusi i banesës, lloji i pronësisë, numri i dhomave dhe pajisje të tjera të infrastrukturës për banesat, pajisjet e tjera sanitare, viti i ndërtimit, lloji i materialit të ndërtesës, numri i kateve të ndërtesës;

2. Të dhënat për ish-anëtarët e ekonomisë familjare, që nuk janë pjesë e popullsisë rezidente të Republikës së Kosovës, shënohen në listën suplementare.

## **Neni 10**

### **Rezultatet e Regjistrimit**

**Pas Pikës 1.1.1 të nenit 10 të Projektligjit** të shtohet dhe të plotësohet, pika si në vijim:

**Pika 1.1.2** Numrin e popullsisë rezidente sipas përkatësive etnike të njohura me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

## **Neni 11**

### **Pyetësi dhe dokumentacioni për Regjistrim**

**Në fund të paragrafit 2 të këtij neni** të shtohet fjalia si në vijim: Në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.

## **Neni 13**

### **Komisioni Qendror i Regjistrimit**

**Pas paragrafit 4.11 të Projektligjit** të shtohet paragrafi 4.12, dhe të jetë si në vijim:

**Paragrafi 4.12** Me nga një (1) përfaqësues të komuniteteve, anëtar;

## **Neni 15**

### **Komisioni Komunal i Regjistrimit**

**Pas paragrafit 5.4 të Projektligjit** të shtohet paragrafi si në vijim:

**Paragrafi 5.5** Nga një (1) përfaqësues të komuniteteve që jetojnë në atë komunë.

**Pas nenit 20 të Projektligjit** të shtohet një neni i ri, si në vijim:

## **Neni 21**

### **Përfaqësimi i komuniteteve në personelin e regjistrimit**

Pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë të jenë të përfaqësuar me së paku 10%, në personelin e regjistrimit.

## **Neni 23**

### **Sanksionet Administrative**

**Paragrafi 2.2 i Projektligjit** të ndryshohet dhe të plotësohet, të jetë si në vijim:

**Paragrafi 2.2** Personi, i cili refuzon t'i japë të dhënat, që i kërkon regjistruesi, ose personi tjetër i autorizuar për Regjistrim, të paraparë me Nenin 4, të këtij ligji, ose jep të dhëna jo të plota ( përfshirë adresën e saktë të vendbanimit rezident) ndëshkohet me gjobë prej pesëqind (500) deri në një mijë (1 000) Euro.

- **Kemi pranuar përgjigje nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, se jemi duke i shqyrtuar rekomandimin dhe komentet e dërguara nga Këshilli Konsultativ për Komunitete.**

### **Rekomandimi i Këshillit për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit**

Ministria të ndërmer veprimet e duhura në mënyrë që:

1. Nxënësve të komunitetit boshnjak dhe komunitetit turk, t'ju sigurohen tekste mësimore në arsimin fillor dhe të mesëm sipas kurrikulës së re për vitin shkollor 2021/2022
  2. Të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë, në vende ku zhvillohet mësimi në gjuhën e tyre amtare, e në përputhje me legjislacionin në fuqi, duhet t'iu mundësohet edukimi në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe të mesëm, pa përcaktimin e pragut të numrit të nevojitur për formimin e një klase, madje edhe në vendbanime ku numri i nxënësve është i vogël.
  3. Të mundësoj organizimin e vijimit të mësimit fakultativ në gjuhën romë nëpër shkolla edhe nëpër komunat e tjera duke marrë modelin e komunës së Prizrenit për mësimin e gjuhës romë si lëndë fakultative, siç parasheh Udhëzimi Administrativ NR.7/ 2010, datë 21.06. 2010.
  4. Bursat për nxënësit e shkollave të mesme për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, të bëhet pagesa së paku në dy muaj, e jo siç është praktika e deritanishme që ka pasur vonesa.
  5. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të përshpejtoj procesin e institucionalizimit të qendrave mësimore për komunitetet rom, ashkali, egjiptian dhe tjerë, siç është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ ( MASHT ) NR. 19/2018 Për Themelimin dhe Funkcionimin e Qendrave Mësimore.
- **Kemi pranuar përgjigjen nga Ministria, se në ndërkohë do t'ju informojmë për ecurinë e rekomandimeve të dhëna.**

Kryesuesi i Grupit Punues për Legjislacion z. Agim Ferati, në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit Konsultativ për Komunitete, më 13 korrik 2021, ka marrë pjesë në

Komisionin për shqyrtimin e nominimeve të kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese.

Kryesuesi i Grupit Punues për Legjislacion z. Agim Ferati, në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit Konsultativ për Komunitete, më 15 korrik 2021, ka marrë pjesë në Komisionin për shqyrtimin e nominimeve të kandidatëve për emërim në Gjykatën Kushtetuese.

Kryesuesi i Grupit Punues për Legjislacion z. Agim Ferati, në cilësinë e përfaqësuesit të Këshillit Konsultativ për Komunitete, më 23 korrik 2021, ka marrë pjesë në Komisionin për testim me shkrim për emërim në Gjykatën Kushtetuese.

## **Gusht**

Më 31 gusht 2021, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.

Gjatë këtij muaji është takuar një (1) grup punues i Këshillit:

- Grupi Punues për Çështje të Kulturës;

Në takim Këshilli ka shqyrtuar dhe miratuar propozim rekomandimin e Grupit Punues për Çështje të Kulturës.

### **Rekomandimi i Këshillit për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

Ministri të ndërmerr veprimet e duhura në mënyrë që:

1. Të mos bëhet dallimi gjatë pagesës së mjeteve financiare për projektet e aprovuara, midis OJQ-ve shumicë dhe jo-shumicë, dhe pagesat të bëhen rregullisht në kohë ose në mënyrë tremujore për një muaj ose dy nëse bëhet fjalë për një projekt disamujor.
2. Pas dorëzimit të dokumenteve të kompletuara për projektin e realizuar me fatura dhe raporte, zyra kompetente për pranim do të lëshojë një vërtetim të pranimit së dokumenteve të specifikuara në mënyrë taksative:
  - Vërtetimi i lëshuar përmban: datën e pranimit, numrin e lëndës, emrin e projektit, dokumentet e dorëzuara, vërtetimi duhet të vërtetohet (vulohet) në dy kopje.
3. Meqenëse shumica e projekteve mbështeten me mjete minimale, kjo gjë reflekton në cilësinë dhe realizimin e projekteve, kështu që ne rekomandojmë që mbështetja financiare të përmirësohet.

Duke iu referuar Rregullores MF-Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ – ve, sipas Nenit 10, 11 dhe 18. Në bazë të këtyre neneve ne rekomandojmë që nëse projektet plotësojnë kriteret dhe nëse përputhen me kërkesat e thirrjes dhe buxheti është real projektet duhet të mbështeten në tërësi.



**Kemi pranuar konfirmimin për pranimin e rekomandimit të dërguar nga Këshilli.** Anëtari i Këshillit, z. Ridvan Gashi, më 04 gusht 2021, ka marrë pjesë në mbledhjen e Grupit punues teknik për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian të organizuar nga Zyra e Kryeministrit.

Kryesuesi i Këshillit, z. Aleksandar Rapajić, më 10 gusht 2021, ka marrë pjesë në debatin publik lidhur me Projektligjin për Regjistrimin të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë, të organizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

## Shtator

Më 30 shtator 2021, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.

Gjatë këtij muaji janë takuar tri (3) grupet punuese të Këshillit:

- Grupi Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale;
- Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve;
- Grupi Punues për Legjislacion.

Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve të Këshillit lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Në takimin e Grupit Punues për Çështje të Gjuhëve, të mbajtur më 27 shtator 2021, ka marrë pjesë znj. Seniha Krasniqi, nga Fakulteti Filologjik, e cila i ka informuar anëtarët e grupit punues lidhur me funksionimin e degës së Ballkanistikës pranë Fakultetit Filologjik në Universitetin e Prishtinës Hasan Prishtina.

Në takimin e Grupit Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale, të mbajtur më 27 shtator 2021, ka marrë pjesë z. Resul Makreshi, Zëvendësministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Në takim anëtarët e grupit punues janë informuar nga zëvendësministri për planin dhe programet e ministrisë për mbështetjen e pjesëtarëve të komuniteteve.

Anëtari Ridvan Gashi, ka marrë pjesë në punëtorinë treditore për Hartimin e Strategjisë për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali 2022- 2026. Punëtorja është organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit dhe është mbajtur më 29 shtator – 01 tetor 2021 në Brezovicë.

## Tetor

Më 28 tetor 2021, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.

Gjatë këtij muaji janë takuar tri (3) grupet punuese të Këshillit:

- Grupi Punues për Çështje të Arsimit;
- Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve;

- Grupi Punues për Legjislacion.

Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Në takim, Këshilli ka shqyrtuar dhe miratuar propozimin për emërimin e nga një (1) përfaqësuesi për anëtarë të Bordit për Politika të Gjuhëve, për secilin nga komunitetet gjuhësore si në vijim: gjuhën shqipe, gjuhën serbe, gjuhën boshnjake, gjuhën turke, gjuhën rome, gjuhën kroate, gjuhën malazeze, gjuhën gorane.

Këshilli, në takim ka zgjedhur kryesinë e re, me mandat një (1) vjeçar. Kryesues është zgjedhur z. Agim Ferati, ndërsa zëvendës kryesuese e parë është zgjedhur, znj. Gúlten Nobirda, dhe zëvendës kryesuesi tjetër, është zgjedhur, z. Fatmir Zymberi.

Në takimin e Grupit Punues për Çështje të Gjuhëve, të mbajtur më 12 tetor 2021, ka marrë pjesë z. Kujtim Gashi, Drejtor në Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI), i cili në takim i informoi anëtarët e grupit punues lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë, në mirëmbajtjen e Web faqeve të komunave.

## Nëntor

Më 25 nëntor 2021, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.

Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve të Këshillit lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Më 03 nëntor 2021, znj. Nafiye Gaş, Sekretare e Këshillit, me zyrtarët e Sekretariatit, ka pritur në takim përfaqësueset e OSBE-së, znj. Shqipe Hajredini dhe znj. Julija Vitanova. Në takim është diskutuar lidhur me bashkëpunimin e Këshillit me OSBE-në si dhe për organizimin e një aktivitetit të përbashkët për shënimin e 10 dhjetorit, Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

Kryesuesi i Këshillit, z. Agim Ferati, ka marrë pjesë në shënimin e 5 Nëntorit Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Rome, të organizuar nga përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit e komunitetit rom, të mbajtur në Fushë Kosovë.

Kryesuesi i Këshillit, z. Agim Ferati, dhe Sekretarja e Këshillit, znj. Nafiye Gaş, më 15 nëntor 2021, kanë pritur në takim, z. Alessandro Rotta, Këshilltar i Lartë i Komisionerit të OSBE-së për Pakicat Kombëtare. Në takim, z. Rotta, është interesuar për rolin dhe pikëpamjet e Këshillit Konsultativ për Komunitete.

Z. Ferati dhe znj. Gaş, e kanë informuar z. Rotta, për rolin, mandatin, organizimin, funksionimin dhe mënyrën e punës së Këshillit Konsultativ për Komunitete.

Grupi Punues për Çështje të Arsimit, ka organizuar tryezën e rrumbullakët me temën "Gjendja në arsim për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës", më 18 nëntor 2021 në Prizren. Në tryezën e organizuar, përpos kryesuesit të Këshillit, z. Agim Ferati, dhe anëtarëve të Grupit Punues për Çështje të Arsimit,

pjesëmarrës ishin edhe: z. Avni Morina, Drejtor në Drejtorinë e Arsimit, dhe z. Lendrit Qeli, Udhëheqës i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, në komunën e Rahovecit, z. Orhan Volkan, përfaqësues i komunitetit turk, Inspektor i Arsimit dhe z. Hajrula Birdaini, përfaqësues i komunitetit boshnjak dhe Inspektor i Arsimit, në komunën e Prizrenit, si dhe z. Nazmi Morina përfaqësues nga komuna e Mamushës.

Kryesuesi i Grupit Punues për Çështje të Arsimit, z. Atakan Koro, i njoftoi të pranishmit me punë e grupit punues gjatë këtij viti, lidhur me çështjet e diskutuara dhe të adresuara në institucionet përkatëse, si dhe me takimin e realizuar, me z. Dukagjin Pupovci, Zëvendësministër në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Pjesëmarrësit e tjerë në tryezë, në diskutimet e tyre, prezantuan punën, angazhimin si dhe sfidat me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në arsim, në komunat e tyre përkatëse.

Pjesëmarrësit në tryezë, e vlerësuan si të dobishme organizimin e tryezës dhe mundësinë që së bashku të diskutojnë për çështjet dhe problemet, me të cilat ndër vite po ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, në lëmin e arsimit, si dhe theksuan nevojën që të gjithë të ofrojnë kontributin në adresimin e të gjitha çështjeve, me qëllim të zgjidhjes sa më parë të tyre.

## Dhjetor

Më 23 dhjetor 2021, Këshilli ka mbajtur takimin e rregullt mujor.

Gjatë këtij muaji janë takuar dy (2) grupe punuese të Këshillit:

- Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve;
- Grupi Punues për Legjislacion.

Kryesuesi i Këshillit dhe kryesuesit e grupeve punuese kanë raportuar para anëtarëve lidhur me aktivitetet e realizuara ndërmjet dy takimeve të Këshillit.

Në takim, Këshilli ka shqyrtuar dhe miratuar propozim planin vjetor të punës për vitin 2022.

Këshilli ka shqyrtuar dhe miratuar propozim rekomandimin për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

## Rekomandimi i Këshillit për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

**Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal,** Propozim Udhëzimin Administrativ për Ndryshimin e Udhëzimit 2011/02 për Përcaktimin e Procedurave për Zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve ta tërheq nga konsultimet publike dhe ta shtyjë për vitin e ardhshëm, në mënyrë që të ofrojë kohë dhe hapësirë të mjaftueshme për

komente dhe propozime shtesë, si dhe të përfshijë në grupin punues për hartimin e tij, Zyrën e Komisionerit për Gjuhët dhe Këshillin Konsultativ për Komunitete.

**Kemi pranuar përgjigjen kthyesë nga Ministria, rekomandimi i Këshillit është respektuar.**

Këshilli Konsultativ për Komunitete me datë 02 -04 dhjetor 2021, ka organizuar Punëtorinë për hartimin e propozim Planin Vjetor të Punës së Këshillit, për vitin 2022. Anëtarët pjesëmarrës në punëtori, gjatë punës së tyre të ndarë në grupe punuese, kanë kontribuar me anë të paraqitjes së propozimeve konkrete nga secili grup punues për hartimin e këtij plani.

Kryesia e Këshillit, z. Agim Ferati, znj. Gúlten Nobirda, z. Fatmir Zymberi dhe përfaqësuesi i komunitetit ashkali, z. Besart Jashari, më 08 dhjetor kanë realizuar një takim me znj. Emilija Redžepi, Zëvendëskryeministre për të Drejtat të Njeriut dhe të Pakicave. Në takim është diskutuar për gjendjen dhe sfidat me të cilat po ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, si dhe me angazhimin e përbashkët për adresimin dhe zgjidhjen e tyre.

Këshilli Konsultativ për Komunitete në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE) Misioni në Kosovë, kanë organizuar punëtorinë për shënimin e 10 Dhjetorit Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

### **Grupet Punuese të Këshillit**

1. Këshilli mund të formojë grupe punuese, të cilat përbëhen më së shumti deri në pesë (5) anëtarë, me qëllim të avancimit të punës për çështje konkrete, apo për fusha specifike të Këshillit.
2. Këshilli do t'i zgjedhë anëtarët e grupeve punuese nga specialistë të fushave të veçanta për të punuar në çështjen specifike për të cilën një grup është themeluar.
3. Grupet punuese raportojnë në takime të rregullta të Këshillit për zbatimin e mandatit dhe aktiviteteve të tyre dhe dorëzojnë raporte dhe rekomandime për miratim në Këshill.
4. Grupet punues e pasqyrojnë përbërjen gjinore dhe atë të komuniteteve.
5. Grupet punuese diskutojnë dhe trajtojnë çështje për të cilat vlerësojnë se janë të rëndësishme dhe me interes për komunitetet në takimet e tyre dhe për çështjet e diskutuara dhe të trajtuara informojnë në takimet e rregullta të Këshillit, duke ofruar edhe propozime konkrete për adresimin e çështjeve të diskutuara.
6. Secili grup punues zgjedh kryesuesin e vet dhe një (1) zëvendës kryesues nga mesi i anëtarëve të rregullt të Këshillit që përfaqësojnë komunitetet.

Në kuadër të Këshillit janë të formuara pesë (5) grupe punuese.

Grupi Punues për Çështje të Arsimit

Grupi Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale

Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve

Grupi Punues për Çështje të Kulturës

Grupi Punues për Legjislacion.

**Grupi Punues për Çështje të Arsimit** ka mbajtur gjashtë (6) takime, në të cilat janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje lidhur me:

- Njohjen e mangësive, eliminimin e mangësive dhe përmirësimin e mësimin online;
- Sistemin arsimor dhe problemet e arsimtarëve të komunitetit goran;
- Mungesën e materialeve informuese dhe paralajmëruese për pandeminë në media, institucionet arsimore shumëgjuhëshe dhe institucionet shëndetësore;
- Mungesën e teksteve mësimore për nxënësit pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë;
- Përgatitjen e propozim rekomandimit për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit;
- Organizimin e tryezës së rrumbullakët me temën “Gjendja në arsim për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komunat e Republikës së Kosovës”.

**Grupi Punues për Çështje të Gjuhëve** ka mbajtur dhjetë (10) takime, në të cilat janë shqyrtuar dhe diskutuar çështje lidhur me:

- Aktivitetet e grupit punues për vitin 2021;
- Përgatitjen e propozim-rekomandimit për zbatimin e të drejtave gjuhësore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Institutin Kombëtar për Shëndetësi Publike të Kosovës;
- Shënimin e Ditës Botërore të Gjuhës Amtare;
- Komentet e dërguara nga Zyra e Komisionerit për Gjuhët në Udhëzimin Administrativ (MPB) NR. 00/2021 Për Dokumentet e Gjendjes Civile;
- Letërnjoftimet në gjuhët e komuniteteve, Platforma E-Kosova, probleme me gjuhët e tjera. Mos implementimi i gjuhës rome në përdorim zyrtar në komunën e Graçanicës;
- Përgatitjen e propozim rekomandimit për zbatimin e të drejtave gjuhësore për Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Agjencinë Shoqërisë së Informacionit;
- Gabimet gjuhësore në gjuhën serbe në fletën e gjobave policore në Kosovë;
- Takim me z. Elbert Krasniqi – Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Numrin e vogël të përkthyesve nga komunitetet në nivel lokal dhe atë qendror si dhe problemet me web faqe të komunave në gjuhët zyrtare;
- Shënimin e 26 Shtatorit Ditës Evropiane të Gjuhëve;
- Takimin me z. Kujtim Gashi – Agjencia e Shoqërisë së Informacionit – ASHI;

- Shqyrtimin e propozim udhëzimit administrativ për ndryshimin e Udhëzimit 2011/02 Për Përcaktimin e Procedurave për Zbatimin e Ligjit Për Përdorimin e Gjuhëve në Komuna - përgatitja e propozim rekomandimit për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

**Grupi Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale** ka mbajtur gjashtë (6) takime, në të cilat janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje si në vijim:

- Diskutim lidhur me aktivitetet e grupit punues për vitin 2021;
- Takim me përfaqësuesin e UNICEF-it, Sektori për Mbrojtje Sociale, z. Dren Rexha dhe z. Afrim Ibrahim;
- Diskutim mbi ndikimin e pandemisë në ngritjen e papunësisë të komuniteteve jo shumicë ;
- Takim me z. Gazmen Salijević, Zëvendësministër në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim;
- Takim me z. Resul Makreshi, Zëvendësministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve.

**Grupi Punues për Çështje të Kulturës** ka mbajtur pesë (5) takime, në të cilat janë diskutuar çështje lidhur me:

- Aktivitetet e grupit punues për vitin 2021 ;
- Aktivitet kulturore gjatë pandemisë;
- Problemet e komuniteteve jo shumicë gjatë pandemisë, të ftuar përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Diversitetit Kulturor për Dialog dhe Zhvillim;
- Financimin e aktiviteteve kulturore nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Hartimin e rekomandimit në lidhje me financimin e aktiviteteve kulturore nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

**Grupi Punues për Legjislacion** ka mbajtur shtatë (7) takime, në të cilat janë diskutuar dhe shqyrtuar çështjet përkatëse lidhur me:

- Legjislacionin për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve jo shumicë, vendet e rezervuara;
- Shqyrtimin e Programit Legjislativ për Vitin 2021;
- Shqyrtimin e Projektligjit për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave;
- Shqyrtimin e Projektligjit për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit NR – 04/ L-017 Për Ndihmën Juridike Falas;
- Shqyrtimin e Projektligjit Për Financat e Pushtetit Lokal;
- Shqyrtimin e Projektligjit Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;

- Shqyrtimin e Projektligjit Për Zhvillimin Rajonal.

### Aktivitetet e Sekretariatit të Këshillit

Sekretariati i Këshillit, në zbatim të përgjegjësive dhe detyrave, siç janë përshkruar edhe në pikën V të këtij Raporti, ka punuar me përkushtim në përmbushjen e tyre, me kohë ka arritur të sigurojë shërbimet profesionale dhe administrative për Këshillin dhe grupet punuese të tij.

Angazhimi i Sekretares dhe stafit të Sekretariatit ka qenë i fokusuar në organizimin dhe në mbarëvajtjen e dymbëdhjetë (12) takimeve të rregullta të Këshillit, të një (1) takimi të Presidentes me Këshillin dhe të tridhjetë e gjashtë (36) takimeve të grupeve punuese.

Në konsultim me kryesinë e Këshillit, kryesuesit e grupeve punuese kanë përgatitur ftesat me rendin e ditës dhe materialin tjetër përcjellës, të cilat në afatin e duhur kohor i janë dërguar anëtarëve të Këshillit, përkatësisht anëtarëve të grupeve punuese.

Kanë përpiluar komunikatat për shtyp, procesverbalet, vendimet dhe rekomandimet nga takimet e lartpërmendura.

Kanë këshilluar anëtarët e Këshillit, në çështjet e ngritura për trajtim si dhe për çështjet e tjera që kanë të bëjnë me punën dhe mandatin e Këshillit Konsultativ për Komunitete.

Ka përgatitur organizimin dhe mbajtjen e një (1) tryeze të rrumbullakët, në të cilën kanë marrë pjesë anëtarët e Grupit Punues për Çështje të Arsimit dhe përfaqësues të drejtorive të arsimit nga komunat.

Ka përgatitur dhe organizuar pesë (5) takime me Organizatat Përfaqësuese të Komuniteteve.

Janë përkujdesur që të sigurohet dhe të realizohet në mënyrë të kënaqshme bashkëpunimi përveç me institucionet shtetërore edhe me mediat, organizatat ndërkombëtare, me OJQ-të dhe përfaqësues të tjerë të nivelit komunal, si me Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, dhe Komitetet për Komunitete në komuna.

Sekretariati në bashkëpunim me Zyrën e Presidentes të Republikës dhe në pajtueshmëri me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, ka menaxhuar dhe ekzekutuar me sukses pjesën e buxhetit që i përket Këshillit.

### VIII. Organizimi i takimeve me Organizatat Përfaqësuese të Komuniteteve

Bazuar në planin vjetor të punës, Sekretariati ka organizuar takimet me Organizatat Përfaqësuese të komuniteteve, si në vijim:

Anëtarët e Komunitetit Egjiptian në Këshill, kanë organizuar dhe mbajtur takim me organizatat përfaqësuese të këtij komuniteti më 21 maj 2021, në Radavcë, Pejë.

**Përfaqësuesit e komunitetit Egjiptian në Këshill**, znj. Adelina Qorraj Emini dhe z. Fatmir Zymberi, në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Këshillit, si dhe në bashkëpunim me Sekretariatit e Këshillit organizuan një takim me Organizatat Përfaqësuese të Komunitetit egjiptian, pjesëmarrëse në procesin e nominimit për anëtarët e komunitetit egjiptian në Këshillin Konsultativ për Komunitete. Në takim znj. Adelina Qorraj Emini, i njoftoi pjesëmarrësit me punën e deritanishme të Këshillit, që nga koha e emërimit të tyre në Këshill, si dhe me punën e Grupit Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale, në cilësinë e kryesues së këtij grupi punues.

Z. Fatmir Zymberi, në diskutimin e tij i njoftoi pjesëmarrësit për punën e Grupit Punues për Legjislacion. Pas njoftimit nga znj. Adelina Qorraj Emini dhe z. Fatmir Zymberi, pjesëmarrësit në takim në kuadër të diskutimit të hapur, ngritën çështje si punësimi jo i mjaftueshëm i pjesëtarëve të komunitetit egjiptian, sfidat dhe vështirësitë në fushën e arsimit, gjendja e vështirë socio ekonomike e pjesëtarëve të komunitetit egjiptian, si dhe kërkuan nga dy anëtarët në Këshill, që gjatë punës së tyre në grupe punuese dhe në Këshill, të trajtojnë dhe të angazhohen në adresimin e çështjeve të ngritura nga ta.

Anëtarët e komunitetit Turk në Këshill, kanë organizuar dhe mbajtur takim me organizatat përfaqësuese të këtij komuniteti më 22 qershor 2021, në Prishtinë.

**Përfaqësuesit e komunitetit Turk në Këshill**, znj. Gulden Nobirda, znj. Sevim Brveniku dhe z. Atakan Koro, në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Këshillit, si dhe në bashkëpunim me Sekretariatit e Këshillit organizuan një takim me Organizatat Përfaqësuese të Komunitetit turk, pjesëmarrëse në procesin e nominimit për anëtarët e komunitetit turk në Këshillin Konsultativ për Komunitete. Në takim znj. Gulden Nobirda, i njoftoi pjesëmarrësit me punën e deritanishme të Këshillit, që nga koha e emërimit të tyre në Këshill, si dhe me punën e Grupit Punues për Legjislacion, në cilësinë e zëvendës kryesueses së këtij grupi punues.

Znj. Sevim Brveniku, në diskutimin e saj i njoftoi pjesëmarrësit për punën e Grupit Punues për Çështje të Kulturës, ndërsa z. Atakan Koro, në cilësinë e kryesuesit të Grupit Punues për Çështje të Arsimit.

Pas njoftimit nga znj. Gülten Nobirda dhe z. Sevim Berveniku dhe Z. Atakan Koro, pjesëmarrësit në takim në kuadër të diskutimit të hapur, ngritën çështje si punësimi jo i mjaftueshëm i pjesëtarëve të komunitetit turk, sfidat dhe vështirësitë në fushën e arsimit, kulturës dhe gjuhës e pjesëtarëve të komunitetit turk, si dhe kërkuan nga tre anëtarët në Këshill, që gjatë punës së tyre në grupe punuese dhe në Këshill, të trajtojnë dhe të angazhohen në adresimin e çështjeve të ngritura nga ta.



Nga pjesëmarrësit në takim, u vlerësua si shumë i dobishëm një organizimi i tillë sepse ofron bashkëpunimin dhe bashkëveprimin ndërmjet anëtarëve të Këshillit dhe organizatave përfaqësuese të komunitetit turk.

Anëtarët e komunitetit Rom në Këshill, kanë organizuar dhe mbajtur takim me organizatat përfaqësuese të këtij komuniteti më 29 qershor 2021 në Prishtinë.

**Përfaqësuesit e komunitetit Rom në Këshill**, z. Ridvan Gashi, dhe z. Senad Gushani, në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Këshillit, si dhe në bashkëpunim me Sekretariatit e Këshillit organizuan një takim me Organizatat Përfaqësuese të Komunitetit rom, pjesëmarrëse në procesin e nominimit për anëtarët e komunitetit rom në Këshillin Konsultativ për Komunitete. Në takim z. Ridvan Gashi, i njoftoi pjesëmarrësit me punën e deritanishme të Këshillit, që nga koha e emërimit të tyre në Këshill, si dhe me punën e Grupit Punues për Çështje të Gjuhëve, në cilësinë e kryesuesit së këtij grupi punues.

Z. Senad Gushani, në diskutimin e tij i njoftoi pjesëmarrësit për punën e Grupit Punues për Çështje të Arsimit.

Pas njoftimit nga z. Ridvan Gashi, dhe z. Senad Gushani, pjesëmarrësit në takim në kuadër të diskutimit të hapur, ngritën çështje si punësimi jo i mjaftueshëm i pjesëtarëve të komunitetit rom, sfidat dhe vështirësitë në fushën e arsimit, kulturës dhe gjuhët e pjesëtarëve të komunitetit rom, si dhe kërkuan nga dy anëtarët në Këshill, që gjatë punës së tyre në grupe punuese dhe në Këshill, të trajtojnë dhe të angazhohen në adresimin e çështjeve të ngritura nga ta.

Nga pjesëmarrësit në takim u vlerësua si shumë i dobishëm një organizimi i tillë sepse ofron bashkëpunimin dhe bashkëveprimin ndërmjet anëtarëve të Këshillit dhe organizatave përfaqësuese të komunitetit rom.

Anëtarët e komunitetit Malazez në Këshill, kanë mbajtur takim me organizatat përfaqësuese të këtij komuniteti më 08 korrik 2021 në Prishtinë.

**Përfaqësuesit e komunitetit Malazez në Këshill**, znj. Vesna Dabetić dhe z. Denis Ivić, në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Këshillit, si dhe në bashkëpunim me Sekretariatit e Këshillit organizuan një takim me Organizatat Përfaqësuese të Komunitetit malazez, pjesëmarrëse në procesin e nominimit për anëtarët e komunitetit egjiptian në Këshillin Konsultativ për Komunitete. Në takim znj. Vesna Dabetić, i njoftoi pjesëmarrësit me punën e deritanishme të Këshillit, që nga koha e emërimit të tyre në Këshill, si dhe me punën e Grupit Punues për Çështje të Gjuhëve, në cilësinë e anëtares së këtij grupi punues.

Z. Denis Ivić, në diskutimin e tij i njoftoi pjesëmarrësit për punën e Grupit Punues për Çështje të Punësimit dhe Çështje Sociale. Pas njoftimit nga znj. Vesna Dabetić dhe z. Denis Ivić, pjesëmarrësit në takim në kuadër të diskutimit të hapur, ngritën çështje si punësimi jo i mjaftueshëm i pjesëtarëve të komunitetit malazez, gjendja e vështirë socio ekonomike e pjesëtarëve të komunitetit malazez, si dhe kërkuan nga dy anëtarët në

Këshill, që gjatë punës së tyre në grupe punuese dhe në Këshill, të trajtojnë dhe të angazhohen në adresimin e çështjeve të ngritura nga ta.

Anëtarët e komunitetit Rom në Këshill, kanë organizuar dhe mbajtur takim me organizatat përfaqësuese të këtij komuniteti më 29 qershor 2021 në Prishtinë.

Anëtarët e komunitetit boshnjak në Këshill, kanë organizuar dhe mbajtur takim me organizatat përfaqësuese të këtij komuniteti më 07 dhjetor 2021, në Prizren.

**Përfaqësuesit e komunitetit Boshnjak në Këshill, z. Agim Ferati, znj. Senada Sagdati dhe z. Almedin Fejza, në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Këshillit, si dhe në bashkëpunim me Sekretariatit e Këshillit organizuan një takim me Organizatat Përfaqësuese të Komunitetit boshnjak, pjesëmarrëse në procesin e nominimit për anëtarët e këtij komuniteti në Këshillin Konsultativ për Komunitete.**

Në takim z. Agim Ferati, në cilësinë e kryesuesit të Këshillit i njoftoi pjesëmarrësit me punën e deritanishme të Këshillit, për gjatë vitit 2021, si dhe me punën e Grupit Punues për Legjislacion, gjatë kohës sa ka qenë kryesues i këtij grupi punues.

Znj. Senada Sagdati, në diskutimin e saj, në mënyrë kronologjike i njoftoi pjesëmarrësit për punën e Grupit Punues për Çështje të Arsimit, ndërsa z. Almedin Fejza, në mënyrë të detajuar i njoftoi pjesëmarrësit për punën e Grupit Punues për Çështje të Gjuhëve, si dhe për disa nga aktivitetet e Grupit Punues për Çështje të Kulturës, dhe të Këshillit në tërësi.

Pas njoftimit nga z. Agim Frati, znj. Senada Sagdati dhe z. Almedin Fejza, pjesëmarrësit në takim në kuadër të diskutimit të hapur, ngritën çështje si zbatimi jo i kënaqshëm i ligjit për përdorimin e gjuhëve në komunën e Prizrenit, sfidat dhe vështirësitë në fushën e arsimit, kulturës dhe të punësimit për pjesëtarët e komunitetit boshnjak, si dhe kërkuan nga tre anëtarët në Këshill, që gjatë punës së tyre në grupe punuese dhe në Këshill, të trajtojnë dhe të angazhohen në adresimin e çështjeve të ngritura nga ta, por edhe u vlerësua puna dhe kontributi i deritanishëm i tyre në Këshill.

Nga z. Agim Ferati, dhe pjesëmarrësit në takim u vlerësua si shumë i dobishëm një organizimi i tillë sepse ofron mundësinë e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit ndërmjet anëtarëve të Këshillit dhe organizatave përfaqësuese të komunitetit boshnjak, si dhe u kërkua që ky bashkëpunim të intensifikohet në të ardhmen.

**Sekretariati i Këshillit Konsultativ për Komunitete, në kuadër të përgjegjësisë të veta, ka ndihmuar në:** Përgatitjen, organizimin dhe mbarëvajtjen e dymbëdhjetë (12) takimeve të rregullta të Këshillit, të një (1) takimi me Presidenten si dhe të tridhjetë e gjashtë (36) takimeve të grupeve punuese, gjithsej dyzet e nëntë (49) takime, si dhe të pesë (5) takimeve me organizatat përfaqësuese të komuniteteve.

Në konsultim të përhershëm me kryesinë e Këshillit, si dhe kryesuesit e grupeve punuese, me kohë ka përgatitur ftesat dhe rendin e ditës për çdo takim, ka përpiluar komunikatat si dhe procesverbalet nga takimet e realizuara.

Zyrtarët e Sekretariatit, krahas përgjegjësive që kanë nga përshkrimi i vendeve të tyre të punës, në vazhdimësi kanë këshilluar anëtarët e Këshillit, në çështjet e ngritura për shqyrtim, në realizimin e takimeve, si të atyre me përfaqësues të institucioneve vendore, po ashtu dhe me përfaqësuesit institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare të pranishme në Kosovë, në funksion të bashkëpunimit si dhe të shkëmbimit të informatave, të cilat janë në interes të komuniteteve jo shumicë dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

## **IX. Buxheti i Këshillit Konsultativ për Komunitete dhe raporti financiar**

### **1. Buxheti i Këshillit**

Në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit, Këshilli e ka kodin e vet buxhetor në kuadër të buxhetit të Zyrës së Presidentes.

Zyra e Presidentit, me rastin e përcaktimit të shumës së buxhetit vjetor, merr parasysh propozimet e Këshillit.

### **2. Shpenzimet buxhetore sipas kategorive**

Në kategorinë paga dhe mëditje, janë ndarë 36,781.24 €, ndërsa në kategorinë mallra dhe shërbime janë ndarë 82,390.00 €. Vetëm për pagat, përfshirë kontributin pensional dhe tatimin e ndalur në të ardhurat personale, janë paguar në total 41,191.10 €. Buxheti për paga dhe mëditje shprehur në përqindje është shpenzuar 111.99%, ndërsa, në kategorinë mallra dhe shërbime, nga 82,390.00 € sa janë alokuar, janë shpenzuar 51,075.00 €, apo shprehur në përqindje 61.99%. Nga kjo shumë vetëm për mëditjet e anëtarëve të Këshillit dhe paushallin mujor janë paguar 37,158.40 €, kurse për shpenzimet për shërbimet (përkthime, zërimi, mirëmbajtja e web faqes) janë shpenzuar 6,859.54 €. Pjesa tjetër e buxhetit 7,057.06 € është shpenzuar për mbulimin e nevojave të tjera ndërlidhura me aktivitetet e Këshillit, grupeve punuese si dhe bashkëpunimeve ndërinstitucionale, ngritjen e kapaciteteve, dhe shpenzimet e tjera lidhur me furnizimet dhe punën në zyrë. Në total janë shpenzuar 92,266.10 € apo shprehur në përqindje 77.42 % e buxhetit të aprovuar për vitin fiskal 2021.

Kategoria e Buxhetit	Buxheti i alokuar	Buxheti i shpenzuar	Shpenzimet në %
Paga dhe mëditje	36,781.24 €	41,191.10 €	111.99%
Mallra dhe shërbime	82,390.00 €	51,075.00 €	61.99%
Total	119,171.24 €	92,266.10 €	77.42%

*Shpenzimet sipas kategorive buxhetore*

Kategoria e Buxhetit	Mëditje e anëtarëve dhe paushalli mujor	Shpenzimet për shërbimet	Mirëmbajtja e ueb faqes	Shpenzime tjera
Mallra dhe shërbime	37,158.40 €	6,071.98 €	787.56 €	7,057.06 €

*Shpenzimet nga kategoria mallra dhe shërbime*

### 3. Ekzekutimi i buxhetit

Kërkesat për ekzekutimin e pagave, mëditjeve dhe sigurimin e shërbimeve për plotësimin e nevojave të anëtarëve të Këshillit dhe të Sekretariatit, parashtrohen nga ana e Sekretares së Këshillit, ndërsa ekzekutimi i kërkesave bëhet përmes zhvillimit të procedurave nga ana e zyrtarëve përkatës profesional të Zyrës së Presidentit.

Bashkëpunimi me zyrtarët përkatës të Zyrës së Presidenti dhe ekzekutimi i buxhetit nga ana e tyre, sipas kërkesave të Sekretariatit, është zhvilluar në përputhje me procedurat në fuqi dhe në afatet e caktuara.

#### X. Përfundime

Bazuar në mandatin kushtetues dhe ligjor, në përputhje me kapacitetet dhe me mundësitë buxhetore, Këshilli në masën më të madhe edhe përkundër Pandemisë COVID 19, ka arritur objektivat e përcaktuara në planin vjetor të punës për vitin 2021.

Të gjithë anëtarët e Këshillit kanë vijuar me punë në përmbushjen e mandatit kushtetues dhe ligjor.

Të vetëdijshëm për rolin dhe përgjegjësinë e tyre, anëtarët e Këshillit mbeten të përkushtuar që, edhe për gjatë vitit 2022, të vazhdojnë të jenë të angazhuar në thellimin e bashkëpunimit me të gjitha institucionet relevante të vendit, si dhe të zgjerojnë bashkëpunimin me përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare për të siguruar

promovimin, mbrojtjen dhe sigurimin e barazisë së plotë dhe efektive për të gjitha komunitetet dhe pjesëtarët e tyre në Republikën e Kosovës.

**Sfidat e Këshillit për gjatë vitit 2021:**

Sfidat:

Mos marrja e përgjigjeve nga institucionet, në disa nga rekomandimet e dërguara nga Këshilli.